- A) Gjirit.
- B) Endometritit.
- C) Vezores.
- D) Qafës së mitrës.
- E) E kolonit.

PS)A

Pyetja 1365 V)2

Cili nga grupet e gjeneve të histokompatibilitetit përmban allele të lidhur ngushtë me predispozicionin ose refraktaritetin e diabetit mellitus tipi I?

- A) HLA-A
- B) HLA-B
- C) HLA-DP
- D) HLA-DN
- E) HLA-DR

PS)E

Pyetja 1366 V)1

Flitet për hipovolemi relative kur ka

- A) Ulje të fraksionit të ejeksonit.
- B) Shtim të kthimit venoz.
- C) Kapacitet vazal të shtuar në kushte mase normale
- D) Reduktim i kapacitetit vazal me masë qarkulluese normale
- E) Prani eksudatesh intra kaviteteve të sekuestruar

PS)C

Pyetja 1367 V)2

Muskujt kriko-aritenoid lateralë e inter-aritenoide shkaktojnë

- A) Aduksionin e kordave vokale.
- B) Abduksionin e kordave vokale.
- C) Rritjen e tensionit të kordave vokale.
- D) Ngritjen e larinksit.
- E) Uljen e larinksit.

PS)A

Pyetja 1368 V)1

Cila është rruga kryesore e eliminimit nga organizmi i kontrasteve të iodizuar?

- A) Hepatike
- B) Renale
- C) Kutane
- D) Rektale
- E) Salivare

PS)B

Pyetja 1369 V)1

Cilin veprim respirator kryejnë muskujt abdominalë?

- A) Aksion inspirator
- B) Asnjë veprim
- C) Rritjen e presionit intrapleural
- D) Aksion ekspirator
- E) A dhe C janë të sakta

PS)D

Pyetja 1370 V)2

Simptomat e mëposhtme janë efekte kolaterale të zakonshme në përdorimin e benzodiazepinave, përveç

- A) Cefalesë.
- B) Inkoordinimit motor.
- C) Vertigos.
- D) Amnezia anterograde
- E) Konstipacionit.

PS)E

Pyetja 1371 V)3

Tek qelizat eukariote, pjesa më e madhe e enzimave të ciklit të Krebsit janë të lokalizuara në

- A) Citozol.

- B) Aparatin e Golxhit.
 - C) Ribozomë.
 - D) Matriksin mitokondrial.
 - E) Membranën e jashtme mitokondriale.
- PS)D

Pyetja 1372 V)1

Shkaku më i shpeshtë i dështimit të kontraceptivëve oralë, që ka si rezultat një shtatëzani të padëshiruar është

- A) Ovulim në mes të ciklit.
 - B) Frekuenca e raporteve seksuale.
 - C) Përdorimi jo i saktë i kontraceptiveve oralë.
 - D) Malabsorbiment gastrointestinal.
 - E) Prodhim i antitropave.
- PS)C

Pyetja 1373 V)2

Cili fenotip HLA ndeshet më shpesh në sindromën e Reiter?

- A) B16
 - B) B17
 - C) B5
 - D) B27
 - E) B13
- PS)D

Pyetja 1374 V)1

Në cilën ditë, hormoni LH arrin nivelin më të lartë tek një grua që ka një cikël menstrual 30 ditësh?

- A) Ditën e 12-të
 - B) Ditën e 14-të
 - C) Ditën e 16-të
 - D) Ditën e 18-të
 - E) Ditën e 27-të
- PS)C

Pyetja 1375 V)2

Tek pacientët e prekur nga karcinoma rektale

- A) Hemorragjia rektale është e shpeshtë.
- B) Radioterapia adjuvante e kimioterapia nuk përmirësojnë jetëgjatësinë.

- C) Vëndi më i shpeshtë i metastazave është truri.
 - D) Recidiva lokale nuk përbën problem.
 - E) Është e pranishme splenomegalia.
- PS)A

Pyetja 1376 V)3

Cila nga sëmundjet dermatologjike shoqërohet më shpesh me celiakinë?

- A) Dermatiti herpetiform
 - B) Psoriaza
 - C) Pemfigoidi
 - D) Pemfigo
 - E) Urtikaria
- PS)A

Pyetja 1377 V)2

Neuralgjia trigeminale esenciale karakterizohet nga

- A) Kriza të dhëmbëshme akute unilaterale.
 - B) Kriza të dhëmbëshme akute bilaterale.
 - C) Kriza të dhëmbëshme kronike bilaterale.
 - D) Kriza parestezike bilaterale.
 - E) Kriza të dhëmbëshme djegëse bilaterale.
- PS)A

Pyetja 1378 V)2

Një nga komplikimet më të shpeshta të sëmundjes divertikulare të kolonit është

- A) Hemorragjia.
 - B) Okluzioni intestinal.
 - C) Fistula enterokutane.
 - D) Fistula anale.
 - E) Koliti ishemik.
- PS)A

Pyetja 1379 V)2

Në astmën bronkiale, nga çfarë varet ulja e fluksit ekspirator maksimal?

- A) Rritje e kompliancës
- B) Rritje e konduktancës
- C) Ulje e rrezistencës
- D) Rritje e rrezistencës
- E) A-ja e D-ja janë të sakta.

PS)D

Pyetja 1380 V)1

Hemoglobina

- A) Është mesatarisht më e lartë tek meshkujt se tek femrat.
- B) Rritet në rast makrocitoze.
- C) Bën pjesë tek proteinat e fazës akute.
- D) Ka vlera normale 12-17 mg/dl.
- E) Është në gjëndje të transportojë 10 molekula oksigjen për molekulë.

PS)A

Pyetja 1381 V)2

Endokarditi infektiv tek subjektet toksikodependente shkaktohet më shpesh nga

- A) Streptokoku fekal.
- B) Stafilokoku aureus.
- C) Kandida albicans.
- D) Serratia marcescens.
- E) Streptokoku viridans.

PS)B

Pyetja 1382 V)2

Në rastin e diagnozës prenatale të renit multikistik, cila nga manovrat e mëposhtme është e saktë?

- A) Kontroll ekografik të shtatzanisë e sectio cesareo në term fiziologjik.
- B) Kontroll ekografik të shtatzanisë e sectio cesareo përpara termit fiziologjik (sapo të ketë arritur maturitetin pulmonar)
- C) Kontroll ekografik të shtatzanisë e lindje normale në term.
- D) Kontroll ekografik të shtatzanisë e seksio cesareo në muajin e shtatë.
- E) Kontroll ekografik të shtatzanisë dhe induktim të lindjes normale sapo të arrihet.

Maturiteti pulmonar

PS)C

Pyetja 1383 V)1

Probabiliteti që një fëmijë i një pacienti me "hemofili grave" të ketë hemofili është

- A) 0%.
- B) 25%.
- C) 50%.
- D) 75%.
- E) 100%.

PS)A

Pyetja 1384 V)2

Cila nga shenjat e mëposhtme nuk është e pranishme në embolinë pulmonare masive?

- A) Dispnea severe e cinozë
- B) Dhëmbje e tipit anginoz
- C) Deficit i furnizimit cerebral
- D) Edemë në formë manteli
- E) Turgor i venave jugulare

PS)D

Pyetja 1385 V)1

Diabeti në distancë dëmton sistemin nervor, duke shkaktuar kryesisht

- A) Kriza epileptike.
- B) Rritje të frekuencës së tumoreve.
- C) Degjenerim të qelizave të kornu anterior.
- D) Neuropati periferike.
- E) Prekje të sensibilitetit të thellë.

PS)D

Pyetja 1386 V)2

Në rast perforimi të uterusit gjatë një ekzaminimi të kavitetit uterin duhet

- A) Ndërprerë interventi.
- B) Të fillohet një trajtim me antibiotikë.
- C) Të kryhet një laparotomi eksplorative.
- D) Suturimi i dëmtimit.
- E) A+B

PS)E

Pyetja 1387 V)2

Temperaturë intermitente e tipit ondulant shihet shpesh në sëmundjen e

- A) Pertusit.
- B) Tifos abdominale
- C) Difterisë
- D) Brucelozës.
- E) Sepsit puerperal.

PS)D

Pyetja 1388 V)3

Trajtimi më i mirë i metastazave hepatike solitare të karcinomës së kolonit është

- A) Radioterapia.
- B) Kimioterapia.
- C) Kimioterapia nëpërmjet arteries hepatike.
- D) Krioterapia.
- E) Rezekcioni kirurgjikal.

PS)E

Pyetja 1389 V)2

Prekursori i Prostaglandinave është

- A) Acidi arakidonik.
- B) Acidi linoleik.
- C) Acidi palmitik.
- D) Acidi stearik.
- E) Acidi laktik.

PS)A

Pyetja 1390 V)1

Cili është hormoni tiroidien fiziologjikisht më aktiv?

- A) Tireoglobulina
- B) Monoiodotirozina
- C) Diiodotirozina
- D) Triiodotirozina
- E) Tiroxina

PS)D

Pyetja 1391 V)1

Koka dhe pjesa mediale e colli femuri janë të vaskularizuara nga

- A) Arteria femorale komune.
- B) Arteria circumflekse.
- C) Arteria pudente.
- D) Arteria obturatore.
- E) Arteria gluteale.

PS)B

Pyetja 1392 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë kur bëhet fjalë për një pacient me hiperkalçemi nga sarkoidoza?

- A) Radiografia torakale është gjithmonë normale.
- B) Përthithja intestinale e Ca është e rritur.
- C) Eliminimi urinar i Ca është normal.
- D) Niveli i PTH serik është i rritur.
- E) Është shpesh e pranishme hipogamaglobulinemia.

PS)B

Pyetja 1393 V)1

Cila nga vlerat e presionit arterial konsiderohet si limiti superior normal në një subjekt 40 vjeç?

- A) 150/90
- B) 130/70
- C) 140/90
- D) 160/100
- E) 150/100

PS)C

Pyetja 1394 V)2

Një efekt kolateral veçanërisht i rrezikshëm i kloramfenikolit është

- A) Proteinuria.
- B) Ikteri kolostatik.
- C) Agranulocitoza.
- D) Diabeti.
- E) Anemia hemolitike.

PS)C

Pyetja 1395 V)1

Nëse vlerat e hormoneve FT3 dhe FT4 të tiroides janë të rritura, ndërsa vlera e TSH është e ulur (frenuar), mund të jemi në prani të

- A) Infarkt të miokardit.
- B) Metastazave kockore.
- C) Osteomielitit.
- D) Morbus Basedow.
- E) Morbus Alzheimer.

PS)D

Pyetja 1396 V)2

Përdorimi kronik i etanolit shoqërohet me shpeshtësi të rritur të

- A) Kolestazës.

- B) Steatozës.
- C) Hemokromatozës.
- D) Hipertrofisë së retikulumit endoplazmatik.
- E) Nekrozës koagulative.

PS)B

Pyetja 1397 V)1

Cili nga parametrat e mëposhtëm serologjikë duhet monitoruar gjatë terapisë me heparinë?

- A) APTT
- B) PT (koha e protrombinës)
- C) INR (International Normalised Ratio)
- D) Numri i trombociteve
- E) A+D

PS)E

Pyetja 1398 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm që lidhet me insiprimin gjatë maksimumit të provës ushtrimore është i gabuar?

- A) Diafragma zbret më shumë se 3 cm.
- B) Diametri anësor i toraksit rritet.
- C) Muskujt interkostal të jashtëm kontrahohen.
- D) Muskuli sternokleidomastoid kontrahohet.
- E) Presioni intraabdominal reduktohet.

PS)E

Pyetja 1399 V)1

Shkaku më i zakonshëm jo neoplazik i hipopituitarizmit tek të rriturit është

- A) Trauma kraniale.
- B) Infamacioni.
- C) Idiopatike.
- D) Sindroma Sheehan.
- E) Amiloidoza.

PS)D

Pyetja 1400 V)1

Për të penetruar me një age në kavitetin pleurik përgjatë vijës medio-aksilare, kalohet përmes të gjithë strukturave të mëposhtme, përveç

- A) Muskulit interkostal të brendëshëm.
- B) Muskulit ngritës të brinjëve .

- C) muskulit interkostal të jashtëm.
 - D) Pleurës parietale.
 - E) Fascies endotorakale.
- PS)B

Pyetja 1401 V)2

Mohimi i lëshimit të raportit mjekësor është legjitim vetëm nëse

- A) Personi i asistuar mund të ekspozohet ndaj proçedimit penal.
 - B) Personi i asistuar mund të ekspozohet ndaj proçedimit civil.
 - C) Mjeku mund të ekspozohet ndaj proçedimit penal.
 - D) Mjeku mund të ekspozohet ndaj proçedimit civil.
 - E) Asnjëherë.
- PS)A

Pyetja 1402 V)1

Çfarë kemi parasysh kur themi "kohë dyfishimi" (doubling time)?

- A) Koha që i duhet një lezioni nodular për të dyfishuar vëllimin e tij.
 - B) Koha që i duhet një lezioni nodular për të dyfishuar diametrin e tij.
 - C) Koha që i duhet një lezioni nodular për të dyfishuar vëllimin dhe diametrin e tij.
 - D) Koha që i duhet një lezioni nodular për të dhënë metastaza në distancë.
 - E) Koha që i duhet një lezioni nodular për të dyfishuar perimetrin e tij.
- PS)A

Pyetja 1403 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i gabuar?

- A) Citologjia eksfoliative përdoret si screening për karcinomën e qafës së mitrës.
 - B) Citologjia eksfoliative mund të përdoret për diagnozën e karcinomës bronkiale.
 - C) Citologjia eksfoliative përdoret mbi qelizat e përftuara përmes aspirimit me age të hollë (FNA)
 - D) Citologjia eksfoliative ndonjëherë përdoret për diagnozën e sëmundjeve mezoteliale.
 - E) Citologjia eksfoliative mund të përdoret për të studiuar sëmundjet e majës së gjirit
- PS)C

Pyetja 1404 V)1

Lokalizimi më i shpeshtë i një enteriti segmentar është

- A) Ileumi.
- B) Koloni.
- C) Stomaku.
- D) Rektumi.

E) Ezofagu.

PS)A

Pyetja 1405 V)1

Simptoma kryesore e pacientit me akalazi është

A) Apiroza.

B) Dhëmbja epigastrike.

C) Dhëmbja gjate gëlltitjes .

D) Refluksi acid.

E) Disfagia.

PS)E

Pyetja 1406 V)1

Hiperaktiviteti bronkial

A) Shoqërohet gjithmonë me astmë bronkiale të diagnostikuar.

B) Mund të evidentohet edhe tek pacientët asimptomatikë.

C) Zakonisht evidentohet me inhalimin e atropinës.

D) Zakonisht evidentohet me inhalimin e salbutamolit.

E) Theksohet nga inhalimi i antikolinergjikëve si p.sh ipratropium bromur.

PS)B

Pyetja 1407 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm lidhur me amilazën është i gabuar?

A) Gjatë insuficiencës renale kronike, niveli urinar i amilazës është i ulur.

B) Makroamilazemia ndeshet zakonisht gjatë pankreatitit akut.

C) Në prani të makroamilazemisë, nivelet plazmatike të amilazës janë të rritura.

D) Në subjektin normal, rreth 50% e amilazës së pranishme në plazëm është e tipit salivar.

E) Gjatë pankreatitit, rritja e amilazave shoqërohet shpesh nga rritje e njëkohshme e lipazave.

PS)A

Pyetja 1408 V)1

Cila nga karakteristikat e mëposhtme nuk i përket barnave gjenerikë?

A) Prodhohen nga industria.

B) Janë të dobishëm në patologji të shumta, pasi nuk janë specifik.

C) Janë bioekuivalentë krahasuar me barin referencë.

D) Nuk mbrohen nga patentat.

E) Zakonisht kushtojnë më pak krahasuar me barin referencë.

PS)B

Pyetja 1409 V)2

Cili element patogjenetik i mëposhtëm nuk është tipik i astmës bronkiale?

- A) Bronkospazma
- B) Mbiprodhimi i mukusit
- C) Edema e mukozës bronkiale
- D) Infeksion i mukozës bronkiale
- E) Granuloma eozinofile

PS)E

Pyetja 1410 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm lidhur me anti inflamatorët jo steroidal është i vërtetë?

- A) Frenojnë agregimin e trombociteve pasi ulin nivelet plazmatike të Ca^{++} .
- B) Aspirina frenon agregimin e trombociteve pasi frenon ciklooksigenazën.
- C) Rikthimi i trombociteve në funksionin e tyre normal kërkon të paktën 3 javë kohë pas ndërprerjes së administrimit të aspirinës.
- D) Doza antiagregante e aspirinës është 20 mg/kg në ditë.
- E) Të gjithë barnat anti inflamatore josteroidale frenojnë në mënyrë të pakthyeshme agregimin e trombociteve.

PS)B

Pyetja 1411 V)1

Metotreksati është një bar antiblastik i grupit të

- A) Alkilanteve.
- B) Antimetaboliteve.
- C) Antibiotikëve.
- D) Helmeve.
- E) Alkaloideve të vinkës.

PS)B

Pyetja 1412 V)2

Cila alternativë është e saktë kur një i porsalindur prematur ka vështirësi të frymëmarrjes?

- A) Nuk janë zhvilluar ende plotësisht pneumocitet e tipit 1.
- B) Trakea nuk është ende plotësisht e hapur (e përshkueshme).
- C) Nuk është akoma i plotë mikroqarkullimi alveolar.
- D) Nuk janë zhvilluar ende plotësisht pneumocitet e tipit 2.
- E) Nuk janë zhvilluar ende plotësisht terminacionet nervore zonale.

PS)D

Pyetja 1413 V)3

Fibroma jo osifikante :

- A) Zhvillohet nga periosti
 - B) Migron kur është neoplastike
 - C) Ka kufij sklerotik
 - D) Të gjitha sëbashku
- PS)D

Pyetja 1414 V)3

Lezionet me qeliza gjigande prekin :

- A) Regjionin mandibular posterior
 - B) Femrat nën 24 vjeç
 - C) Prekin ose pllaken kortikale vestibulare ose linguale
 - D) Të gjitha të vërteta
- PS)B

Pyetja 1415 V)3

Lezionet me qeliza gjigande përfshijnë :

- A) Osteosarkomën dhe tumorin Braun
 - B) Sëmundjen Paget dhe kerrubizmin
 - C) Kist kockor aneurizmal ,fibroma dhe displazia fibroze
 - D) Të gjitha sëbashku
- PS)D

Pyetja 1416 V)3

Sëmundja Paget :

- A) Nuk është asnjëherë malinje
 - B) Prek kryesisht femrat
 - C) Zhvendos dhëmbët
 - D) Trajtohet me rezeksion
- PS)C

Pyetja 1417 V)3

Tumori Braun :

- A) Shenjat e para janë dhimbja e lamina dura dhe rezorbimi i rrënjëve të dhëmbëve
- B) Shenja e parë është prekja e gingivave
- C) Duhet të ekscizohet

D) Histopatologjia është specifike dhe diagnostike
PS)B

Pyetja 1418 V)3

Kerrubizmi:

A) Është autozomal dominant
B) Prek më shpesh meshkujt
C) Fillon në njërin anë pastaj përfshin tjetrën
D) Të gjitha sëbashku
PS)D

Pyetja 1419 V)3

Përmasa e heparit mund të matet me anë të :

A) Inspeksionit
B) Palpacionit
C) Perkusionit
D) Askultacionit
PS)C

Pyetja 1420 V)3

Shenja normale e Babinskit është :

A) Dorsi fleksion i gishtit të madh të këmbës
B) Dorsi fleksion i thembrës
C) Fleksioni plantar i gishtit të madh të këmbës
D) Hapja e gishtave të këmbës
PS)C

Pyetja 1421 V)3

Pyetje më e rëndësishme gjatë vlerësimit preoperator të funksionit respirator të një pacienti është:

A) Dispnea
B) Zhurmë fërshëlljese
C) Toleranca ndaj sforcos fizike
D) Asnjera prej tyre
PS)C

Pyetja 1422 V)3

Masat pre operatorë për një pacient me histori angina pectoris përfshijnë :

- A) Nitroglicerinë profilaktike
- B) Operim në pozicion ulur
- C) Maskë O2 dhe sedativë
- D) Të gjitha sëbashku

PS)D

Pyetja 1423 V)3

Toleranca ndaj procedurave anestetike dhe kirurgjikale është më e mirë në :

- A) Aneminë akute
- B) Aneminë kronike
- C) Anemi si pasojë e fibrozës së palcës
- D) Anemia Sickle Cell

PS)B

Pyetja 1424 V)3

Tabloja klinike e alergjisë së vërtetë është :

- A) Rashi kutan
- B) Vështirësi në frymëmarrje
- C) Edema asimetrike
- D) Të gjitha sëbashku

PS)D

Pyetja 1425 V)3

PTT normale është :

- A) 12-14 sek
- B) 25-45 sek
- C) 3-5 min
- D) 1-3 min

PS)B

Pyetja 1426 V)3

Numri i përgjithshëm i leukociteve rritet në :

- A) Uremi
- B) Steroide
- C) Hemoragji
- D) Te gjitha sebashku

PS)D

Pyetja 1427 V)3

Përdorimi i kortizonikëve redukton numrin e :

- A) Euzinofileve dhe bazofileve
 - B) Limfociteve
 - C) Eritrociteve
 - D) A dhe B
- PS)D

Pyetja 1428 V)3

Numri i trombociteve rritet pas:

- A) Anemisë me mungesë hekuri
 - B) R.A
 - C) Splenektomi
 - D) Të gjitha sëbashku
- PS)D

Pyetja 1429 V)3

Numri i monociteve rritet në :

- A) TB
 - B) Sëmundje kolagjenoze
 - C) SABE
 - D) Të gjitha sëbashku
- PS)D

Pyetja 1430 V)3

Dehidratimi mund të shkaktojë :

- A) Përqëndrim elektrolitësh
 - B) Mungesë të elektroliteve
 - C) Djersitje
 - D) Ulje të sheqerit në gjak
- PS)A

Pyetja 1431 V)3

Glukoza në gjak rritet në :

- A) Stres ,Diabet ,Shtazani
- B) Hipertiroidizëm,Sëmundja Kushing,Pankreatid
- C) Të gjitha të mësipërmet

D) Asnjëra nga të mësipërmet
PS)C

Pyetja 1432 V)3

Shenja e parë e disfunksionit renal shfaqet në :

A) Kreatinemi
B) Azotemi
C) Analiza e urinës komplet
D) Enët e gjakut në retinë
PS)C

Pyetja 1433 V)3

Niveli i glukozës në 3-4 muajt paraardhës mund të përcaktohet me anë të :

A) Mioglobinës
B) Hemoglobinës së glukozuar
C) ESR
D) Analiza 24 orëshe e urinës
PS)B

Pyetja 1434 V)3

Mamografia:

A) Tregon leziona të barabarta ose më të vogla se 2 mm
B) Tregon leziona të barabarta ose më të vogla se 5 mm
C) Nuk i zbulon 20-22 % të lezioneve
D) Duhet të përsëritet
PS)B

Pyetja 1435 V)3

Kolesteroli në serum rritet në :

A) Hiperlipidemi
B) Pankreatit
C) Diabet
D) Të gjitha sëbashku
PS)D

Pyetja 1436 V)3

Rritja e kalciumit në serum gjendet në :

- A) Hiperparatiroidizëm dhe hipervitaminoza D
 - B) Metastazat kockore dhe mieloma multiple
 - C) Semundja Paget dhe sairroidozat
 - D) Të gjitha sëbashku
- PS)D

Pyetja 1437 V)3

Koha e hemoragjisë është një matje për :

- A) Spazmën vaskulare
 - B) Formimin e tapës platelet
 - C) Koagulimin
 - D) Sasinë e platelet
- PS)B

Pyetja 1438 V)3

Trupat e huaj radioopake në sinus mund të jenë :

- A) Llastik
 - B) Xham
 - C) Zhavorr
 - D) Të gjitha të mësipërmit
- PS)D

Pyetja 1439 V)3

Materialet e oksid zink eugenolit kanë acetat zinku:

- A) 1%
 - B) 15%
 - C) 19%
 - D) 35%
- PS)C

Pyetja 1440 V)3

Përdorimi i gipsit është:

- A) Material mase për protezat parciaie
 - B) Material mase e imët
 - C) Material mase për shinat në paradontozë
 - D) Material mase për protezat totale
- PS)D

Pyetja 1441 V)3

Adezivi i UFI Gel P është:

- A) Celuloid
 - B) Butanon
 - C) Platin
 - D) Salal
- PS)B

Pyetja 1442 V)3

Bazis Plate ka në përberje dyllra mikrokristaline:

- A) 2.5%
 - B) 3%
 - C) 12%
 - D) 67.5%
- PS)A

Pyetja 1443 V)3

Për galvanizimin e protezave metalike dentare përdoret:

- A) Kripa trefishe e cianurit të kaliumit
 - B) Kripa e kallajit
 - C) Hekzacianuri i platinit
 - D) Kripa e Nikelit
- PS)A

Pyetja 1444 V)3

Çfarë vetie është kur oksidi zhvillohet dhe është i qëndrueshëm :

- A) Vetë fizike
 - B) Vetë biologjike
 - C) Vetë kimike
 - D) Vetë mekanike
- PS)C

Pyetja 1445 V)3

Kujt metal i mungon qëndrueshmërinë:

- A) Plumbit
- B) Zinkut
- C) Kromit
- D)

Kallajit
PS)C

Pyetja 1446 V)3

Kujt metali i përket Fortësia 1 kg/mm²:

- A) Kadmiumit
 - B) Plumbit
 - C) Bismuthit
 - D) Kallajit
- PS)B

Pyetja 1447 V)3

Sa është kufiri i elasticitetit të materialeve:

- A) 0.005 - 0.018 %
 - B) 0.5 - 0.18 %
 - C) 0.05 - 0.18 %
 - D) 0.0005 - 0.0018 %
- PS)A

Pyetja 1448 V)3

Cili metal ka temperaturën e shkrirjes 320 grade Celsius:

- A) Argjendi
 - B) Zinku
 - C) Kallaji
 - D) Kadmiumi
- PS)D

Pyetja 1449 V)3

Cilit metal i takon temperatura e vlimit 778 grade Celsius :

- A) Zinkut
 - B) Bakrit
 - C) Argjendit
 - D) Kadmiumit
- PS)D

Pyetja 1450 V)3

Kujt koncepti i referohet karakteristikës që shoqërohet me ngjyrën e objektit:

- A) Ngjyrës
 - B) Vlerës
 - C) Nuancës
 - D) Pastërtisë
- PS)C

Pyetja 1451 V)3

Kujt koncepti i referohet rrezet predominuese ne syrin e njeriut:

- A) Ngjyrës
 - B) Vlerës
 - C) Nuancës
 - D) Ndërtimit strukturor
- PS)A

Pyetja 1452

V)3

Çfare Densitetit kanë keramikat feldshpatike:

- A) 1.7 - 2 gr/cm³
 - B) 2.14 gr/cm³
 - C) 2.4 gr/cm³
 - D) 2.97 gr/cm³
- PS)C

Pyetja 1453 V)3

Nga çfarë përbëhet gipsi i llojit të tretë:

- A) Hemihidrat sulfat kalçiumi
 - B) Alfa hemihidrat sulfat kalçiumi
 - C) Alfa hemihidrat i modifikuar sulfat kalçiumi
 - D) Beta hemihidrat sulfat kalçiumi
- PS)B

Pyetja 1454 V)3

Nga çfarë përbëhet gipsi i llojit të katërt:

- A) Beta hemihidrat sulfat kalçiumi
- B) Alfa hemihidrat sulfat kalçiumi
- C) Hemihidrat sulfat kalçiumi
- D) Alfa hemihidrat i modifikuar

PS)D

Pyetja 1455 V)3

Çfarë koeficienti Bymimi ka allçia Begstone:

- A) 0.09 %
- B) 0.9 %
- C) 0.19 %
- D) 0.15 %

PS)A

Pyetja 1456 V)3

Nëpërmjet kujt reaksioni formohet eugenati i Zinkut në Materialet e masës oksid zink eugenol:

- A) Nëpërmjet reaksionit të oksid zinkut me ujin e pastës së katalizatorit
- B) Nëpërmjet reaksionit të hidroksidit të zinkut me eugenolit
- C) Nëpërmjet reaksionit të oksidit të zinkut me acetat zinkun
- D) Nëpërmjet reaksionit të oksidit të zinkut me Balsam Peruan

PS)B

Pyetja 1457 V)3

Për çfarë përdoren materialet e kompozicionit të nëngrupit të dytë:

- A) Masë funksionale protezë totale
- B) Masë funksionale protezë parciale
- C) Masë për koronat xhaket
- D) Masë për urat fikse

PS)C

Pyetja 1458 V)3

Cila veti e rëndësishme i takon materialit hidrokoloide reversibël:

- A) Të derdhet lehtësisht
- B) Të hiqet lehtësisht nga gipsi
- C) Të mos tkurret
- D) Temperature e kalimit nga gjendja sol në xhel të jetë sa më e afërt me temperaturën e trupit

PS)D

Pyetja 1459 V)3

Për sa kohë ruhet materiali i Agar- agarit në vaskën e ruajtjes :

- A) Për 5 ditë
- B) Për 7 ditë
- C) Për 10 ditë
- D) Për 12 ditë

PS)A

Pyetja 1460 V)3

Cili është materiali dublues:

- A) Stenti
- B) Oksid zink eugenolit
- C) Elastomeret
- D) Kerri jeshil

PS)C

Pyetja 1461 V)3

Cili lloj alginati është i tretshëm në ujë:

- A) Alginat mangani
- B) Alginat joduri
- C) Alginat kalçiumi
- D) Alginat manganiumi

PS)D

Pyetja 1462 V)2

Çfarë lloj okluzioni është okluzioni i hapur :

- A) fiziologjik
- B) patologjik
- C) pat-fiziologjik
- D) fiz-patologjik

PS)B

Pyetja 1463 V)2

Okluzioni i kryqëzuar është:

- A) fiziologjik
- B) pat-fiziologjik
- C) patologjike
- D) fiz-patologjike

PS)C

Pyetja 1464 V)2

Si janë të kthyera sipërfaqet përtypëse të dhëmballëve poshtë sipas kurbës së Ėilsonit:

- A) Janë të kthyera brenda - lartë
 - B) Janë të kthyera jashtë - lartë
 - C) Janë të kthyera lartë - poshtë
 - D) Janë të kthyera lartë dhë brenda
- PS)D

Pyetja 1465 V)2

Sa sisteme kodifikimi të dhëmbëve janë:

- A) 5 sisteme
 - B) 4 sisteme
 - C) 3 sisteme
 - D) 6 sisteme
- PS)A

Pyetja 1466 V)1

Çfarë sistemi kodifikimi për dhëmbët e qumështit përfaqëson formula ABCDE FGHIJ:

- A) European
 - B) Universal
 - C) Palmer
 - D) Chevron
- PS)B

Pyetja 1467 V)1

Çfarë sistem kodifikimi për dhëmbët e qumështit përfaqëson formula EDCBA ABCDE:

- A) European
 - B) FDI
 - C) Palmer
 - D) Universal
- PS)C

Pyetja 1468 V)1

Çfarë sistem kodifikimi për dhëmbët e qumështit përfaqëson formula 55 54 53 52 51 61 62 63 64 65 :

- A) European
 - B) Shevron
 - C) Universal
 - D) FDI
- PS)D

Pyetja 1469 V)1

Në çfarë moshe erupton Incizivi qendror maxilar i qumështit

- A) 10 (8-12) muaj
 - B) 11 (9-13) muaj
 - C) 19 (16-22)muaj
 - D) 16 (13-19)muaj
- PS)A

Pyetja 1470 V)1

Në çfarë moshe erupton Incizivi lateral mandibular i qumështit:

- A) 8 (6-10) muaj
 - B) 13 (10-16) muaj
 - C) 20 (17-23) muaj
 - D) 16 (14-18) muaj
- PS)B

Pyetja 1471 V)1

Në çfarë moshe erupton Incizivi qendror mandibular i qumështit:

- A) 20 (17-23) muaj
 - B) 16 (14-18) muaj
 - C) 13 (10-16) muaj
 - D) 24 (23-31) muaj
- PS)C

Pyetja 1472 V)1

Në çfarë moshe erupton Molari i dytë maxilar i qumështit:

- A) 14 (13-16) muaj
 - B) 19 (16-22) muaj
 - C) 16 (13-19) muaj
 - D) 29 (25-33) muaj
- PS)D

Pyetja 1473 V)1

Në çfarë moshe erupton Molari i parë mandibular i qumështit:

- A) 8 (6-10) muaj
- B) 16 (14-18) muaj
- C) 20 (17-23) muaj
- D) 13 (10-16) muaj

PS)B

Pyetja 1474 V)1

Në çfarë moshe erupton Molari i parë maxilar i qumështit:

- A) 16 (13-19) muaj
- B) 19 (16-22) muaj
- C) 20 (25-33) muaj
- D) 11 (9-13) muaj

PS)A

Pyetja 1475 V)1

Çfarë rëndësie kanë dhëmbët e qumështit:

- A) Në ngjyrën e dhëmbëve
- B) Në formimin e kockave dhe nofullave
- C) Në pamjen e fytyrës
- D) Në madhësinë e gojës

PS)B

Pyetja 1476 V)1

Çfarë rëndësie kanë dhëmbët e qumështit:

- A) Në ngjyrën e dhëmbëve
- B) Në pamjen e fytyrës
- C) Në zhvillimin e muskujve
- D) Në madhësinë e kavitetit oral

PS)C

Pyetja 1477 V)1

Çfarë rëndësie kanë dhëmbët e qumështit:

- A) Në ngjyrën e dhëmbëve
- B) Në pamjen e fytyrës
- C) Në madhësinë e kavitetit oral
- D) Në pozicionimin normal të dhëmbëve të përhershëm

PS)D

Pyetja 1478 V)1

Çfarë rëndësie kanë dhëmbët e qumështit:

- A) Në renditjen e dhëmbëve në harkadë dhe në okluzion
- B) Në ngjyrën e dhëmbëve
- C) Në madhësinë e kavitetit oral
- D) Në pamjen e fytyrës

PS)A

Pyetja 1479 V)1

Si paraqitet zmalti në dhëmbët e qumështit:

- A) I trashë jo i thelluar
- B) I hollë me një thellësi të qëndrueshme
- C) I moderuar jo i qëndrueshëm
- D) I thepisur i qëndrueshëm

PS)B

Pyetja 1480 V)1

Cili nga dhëmbët e qumështit është më i madh:

- A) Kanini
- B) Molari i parë
- C) Molari i dytë
- D) Incizivi lateral

PS)C

Pyetja 1481 V)1

Çfarë kanë dhomat e pulpës dhe pulpa ndërmjet tyre në dhëmbët e qumështit:

- A) Zmalt
- B) Cement
- C) Zmalt-cement
- D) Dentinë

PS)D

Pyetja 1482 V)3

Cili është pohimi i vërtetë:

- A) Lezioni herpetik I thjeshte ka vetëm një vezikul,ndërsa gingivostomatiti ka shumë vezikula
 - B) Lezioni herpetik I thjeshtë shkaktohet nga HSV ndërsa gingivostomatiti nga VZV
 - C) Lezioni herpetik I thjeshtë si dhe gingivostomatitis mund të shkaktohet nga I njëjti virus
 - D) Lezioni herpetik I thjeshte mund të prekë gjithë mukozën ndërsa gingivostomatitis limitohet vetëm në gingiva
- PS)C

Pyetja 1483 V)2

Gingiva e lirë përbëhet nga elementët:

- A) Lingual,palatal,papilla interdental
 - B) Vestibular,lingual/palatal,Papilla interdental
 - C) Vestibular,palatal dhe lingual
 - D) Papilla interdental dhe gingiva e ngjitur
- PS)B

Pyetja 1484 V)1

Cili është roli I qelizave të Langerhans në gingivë;

- A) Funksion sensorial
 - B) Funksion imunitar
 - C) Ndjeshmëri temperature
 - D) Funksion pigmentues
- PS)B

Pyetja 1485 V)2

Funksioni formues I ligamentit periodontal konsiston në aktivitetin e:

- A) Cementoblasteve,fibroblasteve,osteoblasteve
 - B) Amortizimin e forcave,osteklasteve,dhe ankorimin e dhëmbëve
 - C) Cementoklasteve,osteoklasteve dhe ankorimin e dhëmbit
 - D) Nuk ka funksion formues por vetëm mbështetës dhe amortizues te strukturës dhëmbore
- PS)A

Pyetja 1486 V)3

Pllaka subgingivale jo-aderente ka në përbërje:

- A) Kryesisht baktere Gram –,të lëvizshëm ose jo,spiroketa etj.
- B) Kryesisht baktere Gram +
- C) Pothuajse njësoj Gram+ dhe Gram –
- D) Fillimisht Gram – e më pas tejkalohen nga Gram +,filament etj.

PS)A

Pyetja 1487 V)3

Cilët prej faktorëve më poshtë nuk ndikon në sëmundjen gingivare:

- A) Shtatëzania
- B) Cikli menstrual
- C) Valvulopatitë
- D) Diabeti mellitus

PS)C

Pyetja 1488 V)2

Periodontiti Agresiv :

- A) Prek persona të rinj në dekadën 2 – 3,të shëndetshëm dhe pa probleme sistemike
- B) Prek persona të rinj në dekadën 1 – 2,me probleme sistemike
- C) Prek perosna të rinj në dekadën 3–4–5,jo të shëndetshëm dhe me probleme sistemike
- D) Prek persoa të rinj në dekadën 2- 3,pavarësisht problemeve sistemike që mund të ketë

PS)A

Pyetja 1489 V)1

Si paraqitet në radiografi gingiviti:

- A) Shfaqet me recesion dhe ulje të gingivës
- B) Shfaqet me recesion të kockës dhe ulje të nivelit kockor
- C) Nuk shfaqet
- D) Nuk shfaqet në rastin kur gingiviti është në fillimet e procesit inflamator

PS)C

Pyetja 1490 V)2

Indikacionet për ruajtjen e dhëmbëve të qumështit janë:

- A) Pacienti bashkëpunues
- B) Pranimi i terapise nga prindërit
- C) Agenezi e dhëmbëve permanent
- D) Të treja në konsideratë

PS)D

Pyetja 1491 V)2

Kariesi rampant është karakteristike për :

- A) Dhëmbët e qumështit të moshës 3-5 vjec
- B) Në dhëmbët e sistemit dentar mikst

- C) Në dhëmbët e përhershëm të moshës 15-18 vjeç
 - D) Në moshat mbi 50 vjeç
- PS)A

Pyetja 1492 V)2

Dhoma pulpare e dhëmbëve të qumështit përkundrejt dhëmbëve permanent është:

- A) Është më vogël në të gjithë diametrin e saj
 - B) Është më gjerë në të gjithë diametrin e saj
 - C) Është më e gjerë vetëm në proksimitetin e sipërfaqes okluzale
 - D) Është më vogël vetëm në diametrin mezio – distal
- PS)B

Pyetja 1493 V)2

Për një diagnozë radiologjike të kariesit aproksimal janë përcaktuese :

- A) Rx ortopanomike të arkadave dentare
 - B) 2 Rx endorale bite-ëing
 - C) 2Rx endorale peri-apikale
 - D) 2Rx endorale – okluzale
- PS)B

Pyetja 1494 V)2

Qendra e rrotullimit të një dhëmbi ndodhet:

- A) Në apeks të rrënjës
 - B) Në $\frac{1}{2}$ të rrënjës
 - C) Në qendër të koronës klinike
 - D) Nuk është një pikë fikse, varet nga distanca e forcës nga qendra e rezistencës
- PS)D

Pyetja 1495 V)2

Ngjyra gri e errët në dhëmbët me gangrenë pulpare është shkak nga:

- A) Nga pigmente të absorbuara nga smalti
 - B) Nga transformimi i hemoglobines
 - C) Nga transparencja e dentinës së zbutur
 - D) Produkt i degradimit të metabolizmit bakterial
- PS)B

Pyetja 1496 V)2

Dekstrani që ka një rol primar në formimin e pllakës bakteriale është:

- A) Një polisaharid i sintetizuar nga disa bakterie sporogjene

- B) Një polisaharid i sintetizuar nga disa streptokok në prezencë të saharezës
 - C) Një polisaharid i sintetizuar nga disa stafilokok
 - D) Një polisaharid i sintetizuar nga disa laktobacile
- PS)B

Pyetja 1497 V)2

Formula dentare në vazhdim 55 54 53 52 51 përfaqëson:

- A) Denticionin e qumështit në harkadën superiore të majtë
 - B) Denticionin e qumështit në harkadën superiore të djathtë
 - C) Denticionin e qumështit në harkadën inferiore djathtas
 - D) Denticion permanent në harkadën superiore djathtas
- PS)B

Pyetja 1498 V)3

Cilët janë elementët fiziologjikë të dhëmbit të paformuar për të formuar rrënjët dhe apeksin:

- A) Indi pular
 - B) Indi pulpar dhe indi konjuktiv
 - C) Indi epithelial
 - D) Indi cementoid
- PS)B

Pyetja 1499 V)3

Në dhëmbët permanentë me rrënjë të paformuar në mbulimin indirekt formohet:

- A) Dentinë primare
 - B) Dentinë sekondare
 - C) Dentinë terciare
 - D) Dentinë sklerotike
- PS)C

Pyetja 1500 V)3

Kur përdorim MTA në mbulimin direkt të pulpës formimi i urës dentinare formohet:

- A) 6 javë
 - B) 3javë
 - C) 2javë
 - D) 8javë
- PS)B

Pyetja 1501 V)3

Maturimi i dhëmbit dhe vendosja e lidhjes cemento-dentinare ndodh pas daljes së dhëmbit për:

- A) 2vjet
 - B) 2,5vjet
 - C) 3vjet
 - D) 3,4-4vjet
- PS)D

Pyetja 1502 V)3

Dhëmbët permanent dalin në arkadën dentare pasi rrënjët e tyre janë formuar :

- A) 1/3 e rrënjës
 - B) 1/2 e rrënjës
 - C) 2/3 e rrënjës
 - D) Kur është formuar vetëm korona
- PS)C

Pyetja 1503 V)3

Vendosja e varnisheve ndërmjet kavitetit dhe mbushjes shërben për:

- A) Bën hermetike mbushjen
 - B) Mbron pulpën nga stimujt fizikë dhe kimikë
 - C) Lejon një kavitet të ç'rregullt
 - D) E bën mbushjen më të qëndrueshme
- PS)B

Pyetja 1504 V)3

Koronat e incizëve central permanent janë komplet të mineralizuara:

- A) 1-2vjeç
 - B) 2-3vjeç
 - C) 3-4vjeç
 - D) 6-7vjeç
- PS)D

Pyetja 1505 V)3

Në cilën moshë fillon rezorbimi i molarëve të qumështit:

- A) 3-4vjeç
 - B) 4-5vjeç
 - C) 5-6vjeç
 - D) 6-7vjeç
- PS)D

Pyetja 1506 V)3

Gjuha në formën e manaferrave paraqitet ne fëmije:

- A) Variçel
- B) Skarlatine
- C) Difteria
- D) Fruthi

PS)B

Pyetja 1507 V)3

Sistemi dentar i qumshtit kompletoht në:

- A) 20 muaj
- B) 30 muaj
- C) 40
- D) 50

PS)B

Pyetja 1508 V)3

Lënda inorganike në dhëmbë ka më shumë:

- A) Fluorapatit
- B) Hidroksiapatit
- C) Carbonatapatit
- D) Oktacalçiumfosfat

PS)B

Pyetja 1509 V)3

Koagulimi i pulpes realizohet më shpejt në amputimin vital në dhëmbë me rrënjë të paformuar me :

- A) Ca(OH)_2
- B) ZnO
- C) Yag Lazer
- D) Formokrezol

PS)C

Pyetja 1510 V)3

Një fëmijë 11 vjeç me periodontit kronik të fistulizuar te dhëmbit 85 trajtimi do të jetë:

- A) Amputim vital
- B) Perpunim kanalesh dhe mbushje kanalesh
- C) Ekstraksion
- D) Amputim mortal

PS)C

Pyetja 1511 V)3

Në plotësimin e kartelës në pacient me trauma është e rëndësishme:

- A) Anamneza
- B) Egzaminimi klinik
- C) Matja e vitalitetit dhe Radiografia
- D) Të tri opsionet

PS)D

Pyetja 1512 V)3

Rezorbimi i rrënjes të një dhemb qumshti quhet:

- A) Apektomi
- B) Pulpotomi
- C) Rizaliza
- D) Rezektomi

PS)C

Pyetja 1513 V)3

Cilat nga patologjitë jo dentare është përfshirë në opsionet:

- A) Patologji karioze
- B) Patologji traumatike
- C) Patologji e ATM-së
- D) Patologji pulpo-paradontale

PS)C

Pyetja 1514 V)3

Me cilën nga metodat arrihet mjekimi dentar maximal në fëmijë:

- A) Aneztezi locale
- B) Pa anestezi locale
- C) Maska nazale me Protozit Azoti
- D) Anestezi te përgjithëshme

PS)C

Pyetja 1515 V)3

Metoda interceptive e trajtimit të kariesit në fëmijë realizohet:

- A) Silante
- B) Aplikim i verniceve të fluorit
- C) Pastrimi i pllakës bakteriale

D) Të tre opsione janë të sakta
PS)D

Pyetja 1516 V)3

Çfarë perfaqëson bruksizmi në fëmije:

- A) Një intoksikim farmaceutik
 - B) Një lezion të koletit të dhëbit
 - C) Kërcitje të dhëmbëve
 - D) Hipertrofi gingivare
- PS)C

Pyetja 1517 V) 3

Në trajtimin e kariesit në dhëmbët e qumshtit, cili nga materialet ka mundësi më të pakët për karies sekondar:

- A) Amalgami
 - B) Glassionomeri
 - C) Kompoziti
 - D) Kompomeri
- PS)B

Pyetja 1518 V)3

Kur përdoret Ca(OH)_2 në pulpektomi në trajtimin e dhëmbëve të përhershëm me rrënjë të paformuar :

- A) Kur kanali është boshatisur nga Ca(OH)_2
 - B) Kur niveli i Ca(OH)_2 është në mes të kanalit
 - C) Kur niveli i Ca(OH)_2 është zvogluar me 1/3 apikale
 - D) Kur ka pastë Ca(OH)_2 në të gjitha kanalet
- PS) C

Pyetja 1519 V)3

Tek te rinjte cilet dhembe preken me shume nga paradontiti i lokalizuar

- A) Molarët e parë dhe incizivët permanent
 - B) Lateralët
 - C) Premolarët siper
 - D) Molarët e dytë poshtë
- PS) A

Pyetja 1520 V)3

Frekuenca më e larte në traumat e dhëmbëve të përhershëm te femijet është:

- A) 8-10 vjec
 - B) 8-14 vjec
 - C) 8-11vjec
 - D) 7-16 vjec
- PS) C

Pyetja 1521 V)3

Kanini i qumshtit del në muajt:

- A) 12-15 muaj
 - B) 16-20 muaj
 - C) 17-19 muaj
 - D) 20-25 muaj
- PS)B

Pyetja 1522 V) 3

Hiperemia pulpare është e karakterizuar nga:

- A) Fluks i madh i gjakut arterial
 - B) Një dilatim aktiv të enëve të gjakut
 - C) Qëndrim të gjakut venoz në pulpë
 - D) Një rritje të presionit sistolik
- PS) C

Pyetja 1523 V)2

Opaleshenca është përgjegjse për:

- A) kromën
 - B) intensivët
 - C) aureolën incizale
 - D) karakterizimet
- PS)C

Pyetja 1524 V)1

Cementi qelizor formohet :

- A) Në embriogenezë
 - B) Gjatë gjithë jetës
 - C) Si përgjigje ndaj proçeseve karioze
 - D) Si përgjigje ndaj defekteve kuneiforme
- PS)B

Pyetja 1525 V)2

Për restaurimin e një kaviteti të klasës së VJ në molarë do të zgjidhni :

- A) Kompozit fluid
- B) Glass ionomer cement
- C) Kompozit hibrid
- D) Cement oksifosfat

PS)C

Pyetja 1526 V)1

Kariesi sekondar lokalizohet :

- A) Nën mbushje
- B) Në anët e mbushjes
- C) Në bifurkacion
- D) 1/3 cervikale

PS)B

Pyetja 1527 V)1

Pulpa koronare ka :

- A) Më pak enë gjaku se pulpa radikulare
- B) Më shumë elemente qelizor se pulpa radikulare
- C) Më shumë elementë fibrilar se pulpa radikulare
- D) Më pak makrofage se pulpa radikulare

PS)B

Pyetja 1528 V)1

Cili është shkaku i rënies së hershme të mbushjeve me kompozit?

- A) Karies sekondar
- B) Forma e kavitetit
- C) Acidifikim jo korrekt
- D) Vendosja jo korrekte e shtresës izoluese

PS)C

Pyetja 1529 V)1

Llaqet indikohen në mbushjet me :

- A) Kompozit
- B) Kompomer
- C) Glass ionomer cement
- D) Amalgam

PS)D

Pyetja 1530 V)2

Cili shërben si aktivator te kompozitet?

- A) MMA
- B) Hidrokinonet
- C) Kamforkuinon
- D) Oksigjeni

PS)C

Pyetja 1531 V)2

Cili nga restaurimet e mëposhtëme konsumohet më shumë në sipërfaqe?

- A) Restaurim me Glass ionomer cement
- B) Restaurim me kompozit
- C) Restaurim indirekt (inlej) me kompozit
- D) Restaurim indirekt(inlej) me porcelan

PS)A

Pyetja 1532 V)1

Rënja e dhëmbit e merr fillesën nga :

- A) Cementoblastet
- B) Mbeturinat epiteliale te Malases
- C) Laku cervikal
- D) Odontoblastet

PS)C

Pyetja 1533 V)2

Fuqia e bondimit është me e lartënë bondimin me :

- A) Dentinën primare
- B) Cementin
- C) Dentinën sklerotike
- D) Dentinën sekondare

PS)A

Pyetja 1534 V)2

Cili është promotor i adezionit jon-shkëmbyes te Glass ionomer cementet?

- A) Fluoro alumino silikat glassi
- B) Acidi tartarik

- C) Acidi polialkenoik 10%
 - D) Oksidi i stronciumit
- PS)C

Pyetja 1535 V)1

Koefiçienti i bymimit termik i cilit prej materialeve të mëposhteme i përafrohet më shumë atij të dhëmbit?

- A) Kompozit
 - B) Amalgam
 - C) GIC
 - D) Kompomer
- PS)C

Pyetja 1536 V)1

Sterilizimi me kuarç përdoret për:

- A) Instrumentat e vizites
 - B) Anglin e turbinës
 - C) Medikamentet pluhura
 - D) Instrumentat e kanalit
- PS)C

Pyetja 1537 V)2

Epiteli oral e ka origjinën nga:

- A) Mezenkima
 - B) Qelizat e kreshtes nervore
 - C) Ektoderma
 - D) Membrane bazale.
- PS)C

Pyetja 1538 V)2

Për trajtimin e hipersensitivitetit dentinar cilin nga preparatet e mëposhteme do të përdorni?

- A) Hidroksid kalciumi liner
 - B) Varnish fluori
 - C) Eugenat
 - D) Cement karboksilat
- PS)B

Pyetja 1539 V)2

Cilat qeliza diferencohen të parat:

- A) Preodontoblastet
- B) Preadamantoblastet
- C) Precementoblastet
- D) Mbeturinat epiteliale të Malases

PS)B

Pyetja 1540 V)2

Cilën nga metodat e diagnostikimit për detektimin e kariesit aproksimal do të zgjidhni në një grua shtatzënë ?

- A) Radiografi ne kafshim
- B) Panorameks
- C) DIFOTI
- D) Skaner

PS)C

Pyetja 1541 V)1

Përbërja përfundimtare e pështymes së sekretuar varet nga :

- A) sasia e pështymës
- B) sasia e komponenteve organik
- C) shpejtësia e sekretimit
- D) sasia e bikarbonateve

PS)C

Pyetja 1542 V)2

Në zhvillimin embrional të aparatit dentar cilat formacione formohen të parat :

- A) Proçeset maksilare
- B) Proçeset mandibulare
- C) Burbuqet e dhëmbëve permanentë
- D) Buzët dhe proçesi nazal

PS)B

Pyetja 1543 V)3

Pllaka ose Biofilmi Dentar është:

- A) I ndjeshëm nga agjentët ekzogjen antimikrobial
- B) I ndjeshëm nga antitykotikët
- C) Rezistent ndaj agjentëve ekzogjen antimikrobialë
- D) Reagon ndjeshëm nga ndryshimet e temperaturës

PS)C

Pyetja 1544 V)1

Cila nga alternativat e mëposhtme paraqet një strategji komunitare të parandalimit dentar?

- A) Sondimi periodontal
- B) Shpëlarsit me fluor në shkolla
- C) Profilaksia orale
- D) Imazheria digitale

PS)B

Pyetja 1545 V)2

Pështyma e pa stimuluar prodhohet kryesisht nga:

- A) Gjëndrat e vogla salivare në gjithë kavitetin e gojës
- B) Nga gjëndra parotis
- C) Nga gjëndra submandibulare
- D) Nga gjëndra sublinguale

PS)A

Pyetja 1546 V)2

Cila nga alternativat e mëposhtme është diferenca kryesore klinike dhe diagnostike ndërmjet gingivitit dhe periodontitit?

- A) Thellësia e sulkusit
- B) Thellësia e xhepit
- C) Humbja e lidhjes
- D) Evidenca e inflamacionit gingivar

PS)C

Pyetja 1547 V)2

Për sa kohë është në rrezik për të zhvilluar osteoradio nekrozë pacienti me kancer oral?

- A) 1 vit
- B) 5 vjet
- C) 10 vjet
- D) Gjithë jetën

PS)D

Pyetja 1548 V)1

Mukoziti është një shqetësim për pacientet që kanë një nga llojet e trajtimeve të mëposhtme:

- A) Kirurgji
 - B) Radioterapi dhe Kimioterapi
 - C) Antibiotiko terapi
 - D) Kirurgji dhe antibiotiko terapi
- PS)B

Pyetja 1549 V)2

Zona më e zakonshme ku ndodh carcinoma intraorale e qelizës skuamoze është:

- A) Kreshta alveolare
 - B) Qiellza e butë
 - C) Gjuha
 - D) DysHEMEJA e gojës
- PS)C

Pyetja 1550 V)2

Trauma e denticionit primar e ka pikun në moshën:

- A) 2-3 vjec
 - B) 8-9 vjec
 - C) 9-10 vjec
 - D) 11-12 vjec
- PS)A

Pyetja 1551 V)2

Trauma e denticionit permanent e ka pikun në moshën:

- A) 2-3 vjeç
 - B) 4-5 vjeç
 - C) 9-10 vjeç
 - D) 17-18 vjeç
- PS)C

Pyetja 1552 V)2

Lëvizja e dhëmbëve së bashku me procesin alveolar tregon:

- A) Traumë minimale
 - B) Sëmundjet e avancuar periodontale
 - C) Frakturë të kreshtës alveolare
 - D) Moshën e pacientit
- PS)C

Pyetja 1553 V)1

Në ekzaminim fillestar të traumës dentare nuk përfshihet:

- A) Ekzaminimin e indit të butë dhe të fortë
- B) Testi pulpar
- C) Rrezet X
- D) Vlerësimi neurologjik

PS)B

Pyetja 1554 V)3

Cila nga alternativat e mëposhtme është zgjidhja më e mirë për të ruajtur dhëmbët e avulsuar?

- A) Uji i rubinetit
- B) Uji i shishes
- C) Qumështi
- D) Alkooli

PS)C

Pyetja 1555 V)1

Cili nga komponentët e mëposhtëm nuk është pjesë e barrierave mbrojtëse orale, kundër infeksionit?

- A) Epiteli oral
- B) Pështyma
- C) Zmalti
- D) Okluzioni

PS)D

Pyetja 1556 V)3

Në cilën nga patologjitë e mëposhtme përgjigja imunitare është më përgjegjëse për shkatërrimin e indit sesa patogjenët?

- A) Kariesi dentar
- B) Candida albicans
- C) Sëmundja periodontale
- D) Karcinoma e qelizës skuamoze

PS)C

Pyetja 1557 V)2

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është një funksion i pështymës?

- A) Lubrifikues
- B) Buferik

- C) Prodhon faktorin e nekrozës tumorale (TNF alfa)
 - D) Tretja fillestare e karbohidrateve
- PS)C

Pyetja 1558 V)2

Cila nga imunoglobulinat e mëposhtme lidhet më shumë me shëndetin oral?

- A) IgA
 - B) IgG
 - C) IgE
 - D) IgM
- PS)A

Pyetja 1559 V)3

Cili nga përbërësit e fluorit përputhet mirë me karbonatin e kalciumit të përdorur tek pastat e dhëmbëve?

- A) Monofluor fosfat i natriumit
 - B) Fluoruri i kallajit
 - C) Fluori neutral
 - D) Fosfo fluoruri me acid
- PS)A

Pyetja 1560 V)2

Agjenti antibakterial në pastat e dhëmbëve është:

- A) Nitrati i kaliumit
 - B) Triklosani
 - C) Sulfat zinku
 - D) Pirofosfatet e tretshme
- PS)B

Pyetja 1561 V)3

Cila nga alternativat e mëposhtme është ingredient që inkorporohet tek çamçakezët dhe remineralizon lezionet e hershme karioze dhe që njihet si Recaldent?

- A) Xylitol
 - B) Sorbitol
 - C) Kasein
 - D) CPP-ACP (fosfopeptid kazein-fosfat kalciumi amorf)
- PS)D

Pyetja 1562 V)2

Cila nga procedurat e mëposhtme të higjenës orale personale rekomandohet në fillim?

- A) Shpëlarja çdo ditë me klorheksidinë për 2 muaj
- B) Përdorimi i fillit dentar
- C) Përdorimi i një kunji druri trekëndor
- D) Përdorimi i një pastruesi gjuhe

PS)B

Pyetja 1563 V)1

Cila nga kushtet e mëposhtme ndihmon qëndrueshmërinë e silantit?

- A) Sipërfaqja dhëmbore të jetë e lagësht
- B) Sipërfaqja dhëmbore të jetë e thatë
- C) Sipërfaqja dhëmbore të jetë e lëmuar
- D) Sipërfaqja dhëmbore të jetë e demineralizuar

PS)B

Pyetja 1564 V)2

Rritja e sipërfaqes së kontaktit e cila përmirëson adezionin kërkon përdorimin e materialeve dentare:

- A) Bond
- B) Acid
- C) EDTA
- D) NaOCL

PS)B

Pyetja 1565 V)3

Përdorimi i silantit kundërindikohet në:

- A) Fisura të thella
- B) Fisura të thella me lezime fillestare karioze
- C) Për të përmirësuar integritetin marginal të mbushjeve të klasës së I
- D) Fisura me lezime të thella karioze

PS)D

Pyetja 1566 V)1

Cila nga alternativat më poshtë është zgjedhja më e mirë për një vakt antikariogjenik për një pacient me risk të lartë me karies dentar?

- A) Coca-cola
- B) Djathi

- C) Rrushi i thatë
 - D) Biskotat me sodë buke
- PS)B

Pyetja 1567 V)2

Cilat nga alternativat e mëposhtme është zgjedhja më e rëndësishme për reduktimin e kariesit dentar?

- A) Reduktimi i frekuencës së konsumimit të ushqimeve me sheqer dhe atyre të përpunuara, ngjitëse.
 - B) Shtimi i frutave dhe perimeve në dietën ditore
 - C) Reduktimi i sasisë së yndyrnave
 - D) Shtimi i bulmetit në dietë
- PS)A

Pyetja 1568 V)1

Cila nga alternativat e mëposhtme të suplementeve fluorike është më e mirë për foshnjat, në një zonë që nuk ka ujë të pijshëm të fluorizuar?

- A) Tabletat e tretshme të fluorit 5%
 - B) Aplikimet lokale të fluorit
 - C) Fluori me pika
 - D) Tableta e tretshme e fluorit 25%
- PS)C